



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Raporti mbi monitorimin e takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës

JANAR – DHJETOR 2024



Raporti mbi monitorimin e takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës

JANAR – DHJETOR 2024

TITULLI:

**Raporti mbi monitorimin e takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
Këshillit Prokurorial të Kosovës (janar – dhjetor 2024)**

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

2025

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Tringë Smajli no 16, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

*Ky publikim financohet nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të drejtat e autorit © 2025. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose të transmetohet, në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues ose ndryshe, pa pëlqimin paraprak me shkrim të publikuesit.

Përmbajtja

1. Hyrje	6
2. Metodologjia	7
3. Gjetjet nga monitorimi i takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (janar-dhjetor 2024)	8
3.1 Numri i takimeve të zhvilluara	9
3.2 Publikimi i agjendave	10
3.3 Respektimi i dygjuhësisë në publikimin e agjendave	11
3.4 Publikimi i vendimeve të miratuara	12
3.5 Pjesëmarrja e anëtarëve në takime	13
3.6 Vonesat e fillimit të takimeve	15
3.7 Anëtarët më aktiv në takime	16
4. Gjetjet nga monitorimi i takimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës (janar-dhjetor 2024)	17
4.1 Numri i takimeve të zhvilluara	18
4.2 Publikimi i agjendave	19
4.3 Respektimi i dygjuhësisë në publikimin e agjendave	20
4.4 Publikimi i vendimeve të miratuara	21
4.5 Pjesëmarrja e anëtarëve në takime	22
4.6 Vonesat në fillimin e takimeve	23
4.7 Anëtarët më aktiv në takime	24
5. Rekomandime	25

1. Hyrje

Raporti mbi monitorimin e takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) është raporti i dytë që është përpiluar nga Lëvizja FOL, me qëllim që të pasqyrojë të dhënat e mbledhura nga monitorimi i takimeve të KGJK dhe KPK gjatë periudhës së monitorimit (janar-dhjetor 2024). Qëllimi i këtij monitorimi është të avokoj për transparencë dhe llogaridhënie në proceset vendimmarrëse të këtyre institucioneve, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në administrimin e drejtësisë në Kosovë.

Transparenca është një element thelbësor për ndërtimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Ajo ndihmon në garantimin e qëndrueshmërisë dhe integritetit të institucioneve, duke lehtësuar një komunikim të hapur mes qytetarëve dhe këshillave. Në këtë kontekst, monitorimi i takimeve dhe aktiviteteve të KGJK-së dhe KPK-së është një hap i rëndësishëm drejt promovimit të një kulture të përgjegjshmërisë dhe transparencës në administrimin e drejtësisë.

Ky raport i monitorimit do të ndihmojë në vlerësimin e efikasitetit të takimeve të KGJK-së dhe KPK-së, respektimin e afateve ligjore për publikimin e agjendave, si dhe angazhimin e anëtarëve të këtyre këshillave në diskutime. Përmes këtij procesi, Lëvizja FOL synon të identifikojë sfidat dhe mundësitë për përmirësim, duke kontribuar në forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes të këtyre institucioneve.

Përveç analizës së të dhënave të mbledhura, ky raport do të përfshijë gjithashtu rekomandime për përmirësimin e praktikave të KGJK-së dhe KPK-së. Këto rekomandime do të bazohen në gjetjet e monitorimit dhe do të synojnë adresimin e sfidave të identifikuara, si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në këto institucione.

Në vazhdim do të paraqiten të dhënat e monitorimit për KGJK-në dhe KPK-në, që do të ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi performancën e tyre gjatë periudhës së monitorimit. Këto të dhëna do të shërbejnë si një burim i rëndësishëm informacioni për politikën dhe praktikën e ardhshme të këtyre institucioneve, duke ofruar gjithashtu një bazë për dialogun publik mbi reformimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të administratës së drejtësisë në Kosovë.

2. Metodologjia

Lëvizja FOL për përpilimin e këtij raporti, ka përdorur metodën e monitorimit të vazhdueshëm të të gjitha takimeve të mbajtura nga KGJK dhe KPK, duke u bazuar në agjendat e publikuara në ueb faqet zyrtare të të dy këshillave.

Përmes mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, Lëvizja FOL synon të identifikojë sfidat dhe mundësitë për përmirësim në funksionimin e këtyre këshillave, duke kontribuar në forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Rrjedhimisht, qëllimi i këtij monitorimi është të vlerësohet efikasiteti i takimeve, respektimi i afateve ligjore për publikimin e agjendave dhe nivelin e angazhimit të anëtarëve në diskutime.

Lëvizja FOL, ka monitoruar takimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës me prezencë fizike, të cilat takime gjithashtu janë transmetuar live edhe në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa takimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës janë monitoruar online si dhe në prezencë fizike. Të dhënat e mbledhura nga ky proces i monitorimit janë përpunuar në formë infografikash dhe janë publikuar për çdo gjashtë muaj në rrjetet sociale të Lëvizjes FOL.

Lëvizja FOL ka krijuar një përmbledhje të të dhënave që dalin nga takimet e KGJK-së dhe KPK-së, e cila përfshinë:

- *Numrin e takimeve të monitoruara*
- *Respektimin e afateve ligjore për publikimin e agjendave të takimeve*
- *Numrin e agjendave të publikuara në dy gjuhët zyrtare*
- *Prezencën e anëtarëve në takimet e këshillave*
- *Mesataren e vonesave të fillimit të takimeve*
- *Anëtarë të cilët kanë kontribuar më shumë gjatë takimeve*

Këto pika janë trajtuar për të dy institucionet në këtë raport, me qëllim të ofrimit të një pasqyre të qartë mbi performancën e tyre dhe angazhimin e anëtarëve në proceset e vendimmarrjes.

3. Gjetjet nga monitorimi i takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (janar-dhjetor 2024)

Natyra e takimeve, kuorumi dhe vendimmarrja në takimet e KGJK-së janë të rregulluara me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe me Rregulloren nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK-së.¹

Ligji për KGJK-në, përkatësisht neni 14 i tij, ka përcaktuar se takimet e këshillit janë të hapura për publikun, si dhe rendi i ditës do të jetë i qashtëm për publikun 48 orë para takimit ². Në po këtë dispozitë ligjore janë paraparë edhe kushtet kur takimet mund të mbyllen për publikun, si dhe obligimi për publikimin e vendimeve të miratuara nga takimet e mbajtura, të cilat brenda afatit pesë ditor duhet të publikohen në ueb-faqen e këshillit.

Ndërkaq Rregullorja 03/2020 e KGJK-së, në nenet 26 – 42 të saj, ka paraparë edhe miratimin e kalendarit të takimeve në fillim të çdo viti, të cilit KGJK mund t'i shmanget kurdo që e sheh të nevojshme. Kjo rregullore gjithashtu rregullon çështjen e diskutimit të pikave të rendit të ditës dhe votimit, kuoromit, si dhe incizimin e takimeve.

¹ https://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/lgs/43176_Rregullore%20nr.%2003-2020%20mbi%20organizimin%20dhe%20veprimtarine%20e%20Keshillit%20Gjyqesor%20te%20Kosoves.pdf

² Ligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

3.1 Numri i takimeve të zhvilluara

KGjK, me datë 27 dhjetor të vitit 2023 kishte nxjerrë Vendimin nr. 552/2023, përmes të cilit ishte miratuar orari i takimeve të KGjK-së për vitin 2024. Përmes këtij vendimi, ishte planifikuar që gjatë çdo muaji të këtij viti, të mbahen nga 2 takime, sipas datave të parapara në këtë vendim.³

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, KGjK ka mbajtur gjithsej 20 takime, një mesatare prej 2 takimesh në muaj, me disa përjashtime. Në muajin korrik dhe dhjetor janë mbajtur nga 3 takime, ndërsa në shkurt, mars, prill, qershor dhe tetor janë mbajtur nga 2 takime. Ndërsa në janar, maj dhe qershor është mbajtur nga 1 takim.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur datat e takimeve të mbajtura për periudhën janar-dhjetor 2024.

Datat e mbajtjes së takimeve KGjK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2024



Grafikoni 1. Numri dhe datat e mbajtjes së takimeve të KGjK-së për periudhën janar-dhjetor 2024.


3 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, KGjK. nr.552/2023, 27 dhjetor 2023.

3.2 Publikimi i agjendave

Paragrafi 2 i nenit 14 të ligjit për KGJK-në parasheh obligimin e KGJK-së që të publikojë rendin e ditës/agjendën e takimit të paktën 48 orë para mbajtjes së takimit. Megjithatë, nga monitorimi i FOL-it, nga 20 takime të mbajtura, 2 prej agjendave nuk janë publikuar në kohë. Pra, në përputhje me afatet ligjore janë publikuar 18 agjenda.

Kjo e gjetur tregon se KGJK ka arritur të zbatojë në mënyrë të përpiktë obligimet ligjore për publikimin e agjendave, ndryshe nga viti i kaluar, ku numri i agjendave të papublikuara ishte dukshëm më i lartë. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që KGJK të respektojë afatet e përcaktuara me ligj për publikimin e agjendave, duke garantuar kështu transparencë dhe llogaridhënie në proceset e saj vendimmarrëse.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i agjendave të publikuara brenda periudhës së paraparë dhe atyre që nuk kanë arritur të publikohen brenda kësaj periudhe.



Grafikoni 2. Numri i agjendave të publikuara me kohë dhe atyre që nuk janë publikuar me kohë.

3.3 Respektimi i dy gjuhësisë në publikimin e agjendave

Respektimi i dy gjuhësisë në publikimin e agjendave është një tjetër obligim ligjor i cili buron edhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik. Neni 5 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh se gjuhë zyrtare në vendin tonë janë: gjuha shqipe dhe gjuha serbe ⁴. Rrjedhimisht, nga kjo dispozitë kushtetuese rrjedh edhe obligimi që institucionet shtetërore shërbimet e tyre për qytetarët duhet t'i ofrojnë në dy gjuhë zyrtare.

KGjK me aktin e saj nënligjor, përatësisht në Rregulloren 03/2020, ka paraparë obligimin që agjendat e takimeve t'i publikojnë në dy gjuhët zyrtare të vendit: shqip dhe serbisht. Kjo dispozitë paraqet një hap të rëndësishëm për të siguruar që proceset e vendimmarrjes të jenë të qasshme dhe të kuptueshme edhe për komunitetin serb, duke promovuar kështu transparencën dhe përfshirjen e barabartë në informacion publik.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, KGjK ka mbajtur gjithsej 20 takime, ndërsa agjendat në dy gjuhët zyrtare për këto takime janë publikuar sipas afatit ligjor për të gjitha takimet.

Duke e krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2024 KGjK ka arritur që të respektojë në përpikmëri këtë obligim ligjor. Në raportin e vitit të kaluar të FOL ishte identifikuar se në disa raste agjendat nuk publikoheshin në gjuhën serbe, prandaj andaj ishte rekomanduar që KGjK të kujdeset në implementim të kësaj kërkesë ligjore.⁵

Agjendat e
publikuara në
gjuhën shqipe



20

Agjendat e
publikuara në
gjuhën serbe



20

Grafikoni 3. Numri i agjendave të publikuara në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe për takimet e KGjK-së.

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5 paragrafi 1

⁵ Raporti mbi monitorimin e takimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (2023) fq.23

3.4 Publikimi i vendimeve të miratuara

Ligji për KGjK-në, parasheh se vendimet duhet të publikohen në faqen zyrtare të Këshillit brenda pesë ditëve nga miratimi i tyre. Kjo dispozitë ka një rëndësi të veçantë për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien në punën e KGjK-së, duke i mundësuar publikut dhe aktorëve të interesuar të kenë qasje të plotë në informacionin rreth vendimeve dhe politikave që ndikojnë drejtpërdrejt në administrimin e drejtësisë.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, një pjesë e konsiderueshme e vendimeve të miratuara nga KGjK nuk janë publikuar. Kjo gjë është veçanërisht evidente në muajin maj, ku nga 31 vendime të miratuara, vetëm 17 janë publikuar. Rrjedhimisht, KGjK duhet të përmirësojë procesin e publikimit të vendimeve për të rritur llogaridhënien e saj.

Në tabelën e mëposhtme është vendosur numri i vendimeve të miratuara si dhe numri i vendimeve të publikuara në çdo takim të mbajtur.

Datat e mbajtjes së takimeve	Numri i vendimeve të miratuara	Numri i vendimeve të publikuara
25 janar	29	18
22 shkurt	23	18
8 shkurt	14	6
7 mars	11	8
29 mars	12	12
11 prill	15	15
23 prill	12	12
30 maj	31	17
14 qershor	11	8
4 korrik	4	4
18 korrik	14	11
19 korrik	19	19
29 gusht	14	14
12 shtator	20	19
30 shtator	7	7
9 tetor	11	11
10 tetor	10	10
31 tetor	19	19
5 dhjetor	17	17
26 dhjetor	23	21
27 dhjetor	14	14
Total	330	280

Tabela 1. Niveli i publikimit të vendimeve të miratuara nga takimet e mbajtura gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

3.5 Pjesëmarrja e anëtarëve në takime

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, është monitoruar pjesëmarrja e anëtarëve të KGJK në takimet e mbajtura. Nga 20 takime të zhvilluara, kryesisht pjesëmarrës ishin të gjithë anëtarët e Këshillit, përveç muajit maj, qershor, korrik dhe tetor ku kishte munguar nga një anëtarë.

Në këtë pjesë duhet theksuar faktin se gjatë këtij viti të monitorimit, KGJK-së i kishte ndryshuar përbërja. Rrjedhimisht, duhet theksuar se deri në muajin gusht KGJK përbëhej nga 12 anëtarë, mirëpo nga muaji gusht 1 anëtarë nga radhët e komunitetit serb, kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Nga ajo datë, pozita e të njëjtës nuk është plotësuar.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë dispozitat për përzgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së, konkretisht neni 108 paragrafi 6, pika (3) në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se: dy anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar.⁶

Rrjedhimisht, barra për rekrutimin apo plotësimin e kësaj pozite i bie Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku edhe sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës procedura për rekrutim do të duhej të fillonte brenda (30) ditëve nga dita e mbetjes së vendit të lirë.

Në vitin 2024, KGJK ka funksionuar me gjithsej 12 anëtarë, mirëpo pas dorëheqjes së anëtares së komunitetit serb, Adrijana Miletić, më 7 gusht 2024, numri i përgjithshëm i anëtarëve aktiv ka rënë në 11.

Dorëheqja e znj. Miletić është bërë për arsye profesionale. Pas largimit të saj, nga tre vendet e garantuara për përfaqësimin e komuniteteve joshumicë, aktualisht vetëm një është i plotësuar.

Për më tepër, me 22 nëntor të vitit 2023, kryetari i KGJK-së kishte njoftuar zyrtarisht kryetarin e Kuvendit për dorëheqjen e z. Nikola Kabašić nga pozita e anëtarit të Këshillit, i cili po ashtu ishte përfaqësues i komunitetit serb.

Si pasojë e këtyre dorëheqjeve, KGJK ka mbetur me dy vende vakante për përfaqësuesit e komunitetit serb, të cilat ende nuk janë përmbushur nga Kuvendi.

Rrjedhimisht, barra për rekrutimin apo plotësimin e kësaj pozite i bie Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku edhe sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës procedura për rekrutim do të duhej të fillonte brenda (30) ditëve nga dita e mbetjes së vendit të lirë.⁷

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 108 paragrafi 6, pika 3

⁷ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 10 paragrafi 2

Në tabelën e mëposhtëm gjeni numrin e anëtarëve që munguan gjatë takimeve të mbajtura.

Data e takimit	Të pranishëm	Munguan
25 janar	12	0
22 janar	12	0
8 shkurt	12	0
7 mars	12	0
29 mars	12	0
11 prill	11	1
23 prill	12	0
30 maj	11	1
14 qershor	11	1
4 korrik	11	1
18 korrik	11	1
19 korrik	11	1
29 gusht	11	0
12 shtator	11	0
30 shtator	11	0
9 tetor	10	1
10 tetor	11	0
31 tetor	11	0
5 dhjetor	11	0
26 dhjetor	11	0
27 dhjetor	11	0

Tabela 2. Prezenca e anëtarëve në takimet e KGjK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

3.6 Vonesat e fillimit të takimeve

Pavarësisht se orari i fillimit të takimeve është paraparë në agjendat e takimeve, KGjK ka pasur vazhdimisht vonesa në fillimin e takimeve. Në 5 raste, takimet kanë filluar në kohën e paraparë, ndërsa mesatarja e vonesave në takimet tjera ka arritur deri në 10 minuta. Në muajin mars dhe dhjetor vonesat kanë arritur deri në 15 minuta.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur vonesa e takimeve të mbajtura në çdo takim të KGjK-së.

Data e mbajtjes së mbledhjeve	Vonesa e fillimit të takimeve
25 janar	5 minuta
22 janar	10 minuta
8 shkurt	5 minuta
7 mars	10 minuta
29 mars	15 minuta
11 prill	10 minuta
23 prill	10 minuta
30 maj	5 minuta
14 qershor	10 minuta
4 korrik	Ka filluar sipas kohës
18 korrik	Ka filluar sipas kohës
19 korrik	5 minuta
29 gusht	5 minuta
12 shtator	Ka filluar sipas kohës
30 shtator	Ka filluar sipas kohës
9 tetor	Ka filluar sipas kohës
10 tetor	5 minuta
31 tetor	5 minuta
5 dhjetor	5 minuta
26 dhjetor	5 minuta
27 dhjetor	15 minuta

Tabela 3. Vonesat në fillimin e takimeve të KGjK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

3.7 Anëtarët më aktiv në takime

Gjatë periudhës së monitorimit, me vëmendje janë përcjellë diskutimet dhe kontributet e anëtarëve të KGJK, veçanërisht në lidhje me rendin e ditës. Kjo përcjellje ka pasur për qëllim nxitjen e një angazhimi më të madh edhe nga anëtarët e tjerë të Këshillit, për të kontribuar në mënyrë aktive në diskutimet institucionale.

Nga monitorimi i FOL rezulton se tre anëtarët më aktiv të KGJK-së gjatë kësaj periudhe ishin:



Gjyqtarja
Drita Rexhaj



Gjyqtari
Avni Mehmeti



Gjyqtari
Fahret Vellija

4. Gjetjet nga monitorimi i takimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës (janar-dhjetor 2024)

Natyrë, kuorumi dhe vendimmarrja e takimeve të KPK rregullohen me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe me Rregulloren 02/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e KPK-së.⁸

Neni 14 i ligjit për KPK-në përcakton rregullat për mbajtjen e takimeve të këtij institucioni. Sipas kësaj dispozite, rendi i ditës duhet të bëhet publik të paktën 24 orë para takimit. Ky rregull kjo që synon të garantojë transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut. Ky ligj parashikon edhe kushte specifike për mbylljen e takimeve për publikun, duke ofruar balancën midis nevojës për transparencë dhe kërkesave për ruajtjen e konfidencialitetit të çështjeve të caktuara.

Ndërkaq në rregulloren 02/2020, përkatësisht nenet 16-22 të saj, janë përcaktuar më detajisht rrjedhja e takimeve, duke filluar nga natyra publike e takimeve, kuorumi, publikimi i agjendave dhe diskutimet. Ndryshe nga Rregullorja 03/2020 e KGJK-së, në rregulloren e KPK-së nuk është përcaktuar miratimi i kalendarit të takimeve për vitin vijues.


⁸ <https://prokuroriaks.b-cdn.net/ep-content/uploads/2024/07/Rregullore-Nr.02.2020-per-Organizimin-dhe-Veprimtarine-e-Keshillit-Prokurorial-te-Kosoves.pdf>

4.1 Numri i takimeve të zhvilluara

Përgjatë periudhës monitoruese janar-dhjetor 2024, KPK ka mbajtur gjithsej 22 takime. Përveç muajit janar dhe tetor, kur janë mbajtur nga 3 takime, në muajt e tjerë janë mbajtur nga 2 apo nga 1 takim.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur datat në të cilat janë mbajtur takimet e KPK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Datat e mbajtjes së takimeve të KPK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2024



Grafikoni 4. Numri dhe datat e takimeve të KPK-së të mbajtura gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.


4.2 Publikimi i agjendave

Paragrafi 2 i nenit 14 i Ligjit për KPK-në kërkon që rendet e ditës/agjendat e takimeve të KPK-së duhet të publikohen 24 orë para takimit, duke garantuar kështu transparencë dhe llogaridhënie për publikun dhe palët e interesuara.

Nga vlerësimi i të dhënave, rezulton se gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë publikuar gjithsej 22 agjenda për takimet e KPK-së. Megjithatë, jo të gjitha agjendat janë publikuar brenda afatit të kërkuar ligjor.

Nga këto 22 agjenda, 17 prej tyre janë publikuar 24 orë përpara takimeve. Ndërkohë, 5 agjenda të tjera janë publikuar me vonesë, gjë që paraqet një mospërfillje të obligimeve ligjore për transparencën institucionale.

Në grafikën e mëposhtme është paraqitur numri i agjendave të publikuara në kohë dhe atyre që nuk janë publikuar me kohë.



Grafikoni 5. Numri i agjendave të publikuara me kohë dhe atyre që nuk janë publikuar me kohë.

4.3 Respektimi i dy gjuhësisë në publikimin e agjendave

Neni 22 i Rregullores nr. 02/2020 i KPK-së ka paraparë se agjendat, materialet e takimeve, vendimet e këshillit dhe të trupave të tij duhet të publikohen në të dy gjuhët zyrtare..

Gjatë kësaj periudhe, KPK ka publikuar agjendat e takimeve në të dy gjuhët zyrtare. Nga gjithsej 22 takime të mbajtura, 20 agjenda janë publikuar në gjuhën shqipe ndërsa në gjuhën serbe kanë arritur të publikohen vetëm 9 agjenda, duke treguar një shkallë relativisht të lartë të mos zbatimit të rregullores.

Në grafikën e mëposhtme mund të shihet numri i agjendave të KPK-së të publikuara në gjuhën shqipe dhe atë serbe.

Agjendat e
publikuara në
gjuhën shqipe



Agjendat e
publikuara në
gjuhën serbe



Grafikoni 6. Numri i agjendave të takimeve të KPK-së të publikuara në gjuhën shqipe dhe serbe.

4.4 Publikimi i vendimeve të miratuara

Ndonëse Ligji për Këshillin Prokurorial nuk parasheh dispozitë të veçantë ligjore për publikimin e vendimeve gjyqësore, publikimi i vendimeve mbetet një mjet tjetër i rëndësishëm për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në publik.

Gjatë periudhës monitoruese janar – dhjetor 2024, KPK në takimet e saj ka marrë disa vendime, të cilat nuk janë publikuar sipas miratimit të tyre. Vendimet e muajve shkurt, mars, dhe maj nuk janë publikuar në ueb faqen zyrtare të KPK-së.

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur të dhënat e publikimit të vendimeve të KPK-së nga takimet e mbajtura.

Datat e mbajtjes së takimeve	Numri i vendimeve të miratuara	Numri i vendimeve të publikuara
15 Janar	15	6
25 Janar	6	Mbledhja ka dështuar të mbahet
30 Janar	6	4
13 Shkurt	12	0
26 Shkurt	7	0
19 Mars	20	0
29 Mars	7	0
11 Prill	4	-
7 Maj	7	0
28 Maj	6	1
18 Qershor	14	10
11 korrik	12	8
01 gusht	12	9
27 gusht	5	2
24 shtator	11	4
7 tetor	5	0
15 tetor	12	8
31 tetor	7	2
25 nëntor	12	8
29 nëntor	3	-
12 dhjetor	3	-
27 dhjetor	15	7
Total	498	69

Tabela 5. Numri i vendimeve të pbulikuara nga KPK, për periudhën janar-dhjetor 2024

4.5 Pjesëmarrja e anëtarëve në takime

Gjatë periudhës së monitorimit, shumica e anëtarëve të KPK-së kanë qenë të pranishëm në takime. Nga të dhënat e monitorimit, rezulton se mungesa e anëtarëve është evidentuar vetëm gjatë muajit prill dhe gusht, ku kishte munguar nga 1 anëtarë.

Duke pasur parasysh faktin se gjatë vitit 2023, KPK kishte pasur ndryshime në përbërjen e saj, rrjedhimisht nuk ishin të plotësuar pozitat për anëtarët jo-prokuror duke ndikuar në përfaqësimin e plotë të këshillit. Gjatë vitit 2024 këto pozita u plotësuan, në shkurt të vitit 2024 anëtari nga radhët e universiteteve të drejtësisë u betua si anëtarë jo-prokuror, pastaj në muajin mars u betua anëtari nga shoqëria civile, dhe në qershor u betua anëtari nga Oda e Avokatëve të Kosovës, kështu duke siguruar përbërje të plotë të këshillit. Mirëpo, në muajin shtator ofroi dorëheqjen e tij anëtari nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i anëtarëve prezent në takimet e KPK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Data e takimit	Të pranishëm	Munguan
15 Janar	9	0
22 Janar	9	0
30 Janar	9	0
13 Shkurt	9	0
26 Shkurt	10	0
19 Mars	10	0
29 Mars	11	0
11 Prill	9	2
7 Maj	11	0
28 Maj	11	0
18 Qershor	12	0
11 korrik	12	0
01 gusht	12	0
27 gusht	11	1
24 shtator	12	0
7 tetor	11	0
15 tetor	11	0
31 tetor	11	0
25 nëntor	11	0
29 nëntor	11	0
12 dhjetor	11	0
27 dhjetor	11	0

Tabela 6. Vonesat në fillimin e takimeve të KPK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

4.6 Vonesat në fillimin e takimeve

Gjatë periudhës së monitorimit, KPK ka pasur vazhdimisht vonesa në fillimin e takimeve, me një mesatare prej 15 minutash. Vonesa më e gjatë është vërejtur në takimin e datës 29 mars dhe 11 prill, ku takimi ka filluar me 20 minuta vonesë. Ky nivel vonesash paraqet një sfidë serioze në aspektin e respektimit të orareve zyrtare dhe të përkushtimit të kohës për diskutime. Vonesat e përsëritura mund të ndikojnë jo vetëm në kohëzgjatjen e takimeve, por gjithashtu në efikasitetin dhe produktivitetin e punës së këshillit.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur mesatarja e vonesave për secilin takim të KPK-së gjatë periudhës së monitorimit.

Data e mbajtjes së takimeve	Vonesa e fillimit të takimeve
15 janar	15 minuta
25 janar	5 minuta
30 janar	10 minuta
13 shkurt	10 minuta
26 shkurt	10 minuta
19 mars	5 minuta
29 mars	20 minuta
11 prill	20 minuta
7 maj	5 minuta
28 maj	10 minuta
18 maj	10 minuta
11 korrik	10 minuta
01 gusht	15 minuta
27 shtator	15 minuta
24 shtator	5 minuta
7 tetor	10 minuta
15 tetor	5 minuta
31 tetor	10 minuta
25 nëntor	5 minuta
29 nëntor	5 minuta
27 dhjetor	15 minuta

4.7 Anëtarët më aktiv në takime

Gjatë periudhës së monitorimit, anëtarët e KPK-së kanë dhënë në mënyrë të vazhdueshme komente, opinione dhe rekomandime lidhur me çështjet e trajtuara, duke kontribuar në mënyrë të rëndësishme në proceset vendimmarrëse të Këshillit.

Kjo përcjellje e aktivitetit dhe diskutimeve është realizuar me qëllim të nxitjes së një angazhimi më të madh edhe nga anëtarët e tjerë, në mënyrë që të kontribuojnë në mënyrë aktive mbi rendin e ditës.

Anëtarët që kanë qenë më aktivë në këto diskutime gjatë kësaj periudhe janë:



**U.D
Kryeprokurori
i Shtetit Besim
Kelmendi**



**Prokurori
Arian Gashi**



**Prokurorja
Jehona Grantolli**

5. Rekomandime

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe transparencës në veprimtarinë e KPK-së dhe KGJK-së, Lëvizja FOL ka ofruar një sërë rekomandimesh, që synojnë të forcojnë llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e këtyre institucioneve. Këto rekomandime janë:

- Të sigurohet që agjendat e takimeve të publikohen në përputhje me afatet ligjore në uebfaqet zyrtare të KGJK - së dhe KPK - së.

- Të respektohet orari për fillimin e takimeve, ashtu siç është paraparë në agjendë.

- Të sigurohet që të gjitha vendimet e miratuara në mbledhjet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të publikohen sipas afatit ligjor.

- Këshilli Prokurorial i Kosovës të angazhohet për publikimin e të gjitha vendimeve, duke siguruar qasje të lehtë për publikun në informacionin e nevojshëm.

- Këshilli Prokurorial i Kosovë të angazhohet në publikimin e agjendave në gjuhën serbe për të siguruar qasje të lehtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.

- Të gjithë anëtarët e këshillave të angazhohen më aktivisht në takime përmes diskutimeve, duke kontribuar kështu në arritjen e qëllimit të krijimit të këtyre institucioneve.

- Të sigurohet që të publikohen raporte periodike mbi aktivitetet e KPK - së dhe KGJK - së, përfshirë informacione mbi vendimet e marra, takimet e zhvilluara dhe rekomandimet e dhëna, për të rritur transparencën dhe besueshmërinë e institucioneve.
